



Protokoli i shkurtë i mbledhjes së Kuvendit të parë të rregullt të BISHZ-së më 05.12.1998

Vendi: Gasthof Löwen, Bernstrasse 28, 3110 Münsingen; Tel. 031 724 3111
Data: E shtunë, 05 dhjetor 1998 / 14.00-17.00
Kryesues: Dr.sc. Ahmet Xhigoli (kryetar)
Protokoli: Giuliano Iseini (sekretar)
Pjesëmarrës: Rreth 60

Pikat e rendit të ditës:

1. Hapja e Kuvendit dhe përshëndetja e të pranishmëve
2. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 29.11.1997 – 04.12.1998
3. Ndarja e mirënjohjeve
4. Të ndryshme

1. Përshëndetja e të pranishmëve – hapja e Kuvendit

Sipas rendit të ditës të përshkruar në ftesë, kryetari dr.sc. Ahmet Xhigoli bëri hapjen e Kuvendit të parë të rregullt i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe me një minutë heshtje uu nderuan viktimat e rënë për çlirimin e Kosovës. Pastaj nënkryetari Nazmi Jakurti bëri paraqitjen e anëtarëve të Kryesisë. Lexoi rendin e ditës dhe ftoi Lryetarin të paraqes raportin vjetor, nga 29.11.1997 deri më 04.12.1998.

2. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 29.11.1997 - 04.12.1998

Kryetari, dr.sc. Ahmet Xhigoli, me anë të olive në dia.projektor, bëri paraqitjen e raportit vjetor nr.1 para anëtarësisë së gjërë të mbledhur në Kuvendin e parë të rregullt të BISHZ-së. Në mënyrë kronologjike, me



datë me emërtim të posaçëm për çdo aktivitetnu raportua hollësisht.

Raporti vjetor nr.1 i shtypur dhe i lidhur në formë të fletushkës u vë në dispozicion të kuvendarëve dhe të interesuarëve tjerë (shih shtojcën). Gjishashtu anëtarët e shoqatës dhe gjërë pati në dispozicion edhe formularin për regjistrim të anëtarëve rinjë dhe formularin për deklarimin e donatarëve.

Pas paraqitjes së raportit, kryetari z. Xhigoli i ftoi pjeëmarrësit që të kuvendonin për çërshtjet, që ai duke shtjelluar raportin i paratiti si detyra që duhen në Kuvend të zgjidhen për mbarëvajtjen e mëtutjeshme të punës së BISHZ-së.

Akademik Jetullah Haliti-Eti: Përzemërsisht falenderoj të gjithë dhe uroj punë të mbarë në Kuvend.

Sinollah Shehu: Propozoi të rritet kuotizacioni.

Dr. Enver Pula: Viti që kaloi ishte vit i konsolidimit të Shoqatës. Shprehi keqardhje për numrin relativisht të vogël të anëtarësisë. Finansimi i Shoqatës është i domosdoshëm. Uroj punë të mbarë në Kuvend.

Shkëlqim Duraku: Propozoi t'u dërgohet të gjitha familjeve shqiptare në diasporë nga një fletëpagesë nga 5-10 Franga. Ata janë përafërsisht 200.000, kështu do të bëheshte finansimi i Shoqatës.

Nazmi Jakurti: Shpallja e aksionit vjeshtor për financimin e Shoqatës me anë të donatorëve tregoi sukses të dobët. Do të punojmë në realizimin e projekteve për Komunitetin shqiptarë.

Ahmet Xhigoli: Qendra në Bernë funksionon. Në vitin e ardhshëm do të angazhohemi që edhe qendrat në Cyrih dhe Gjenevë të aktivizohen.

Shkëlqim Duraku: Lajmroj për ekzistimin e Web-faqës nga z. Duraku dhe Gjelosh Gjokaj dhe se shiten libra. I ofroj BISHZ-së që të bëjë shitjen e librave të Nebih Duraku, bababit të tij dhe 10% të derdhen në xhirologarinë e BISHZ-së.

Ahmet Xhigoli: Faqja e WWW e shoqatës mund të përdoret. Ne kemi përgatitur të dhënat dhe ndërtuar Web-faqën e BISHZ-së. Vetëm duhet të sigurohen mjetet financiare.

Sulejman Jashari: Lëvdata kryetarit Ahmet Xhigoli. Shoqata duhet të mbështetet pas elaborimit shumë të mirë të formës të punës së Shoqatës. Propozoj që kuotizacioni të jetë Fr. 200.

Prof. Astrit Leka: Trajtim modern i punës nga kryetari. Assesi mos të diskutohet për privatizim të Shoqatës. Rritja e kuotës në Fr. 200.- ose Fr. 250.- do t'i tremb anëtarët. Propozoj që të lutem të japin dhuratë sipas dëshirës dhe mundësisë. Sa i përket finansimit nga afamiljet, më diket joral sepse ne ende nuk jemi dëshmuar që të kemi kredibilitet të drejtë të familjeve shqiptare me një kërkesë të tillë. Të kërkojmë sponsor dhe të drejtohem për ndihmë fondit federal, seksionit për integrimin e të huajve respektivisht të bashkësisë shqiptare. Pastaj foli për betejën e Mirgonit.

Gjuliano Iseini: Të kemi kujdes me sponsorët. Shoqata duhet ta ruaj autonomi e saj. Për shkak të finansimit mos të drejtohet nga sponsorët.

Afrim Rizvanolli: Tërhoqi vërejtjen se seksioni i informimit nuk funksionon dhe anëtarët nuk kanë informata mbi problemet e Shoqatës. Propozoj që kuota të mos jetë më shumë se Fr. 100.-

Pas disa debateve u vendos që kuota të rritet në Fr. 180.-

Ahmet Xhigoli: me shkrim do të lajmërojmë të gjithë anëtarët për caktimin e kuotës.

Tahir Rexhepi: Punën e kryetarit dhe të Shoqatës e vlerësoi shumë. Propozoj që në kuadër të Shoqatës të



vepron seksioni i Religjionit (Fesë). Ai tërhoqi vërejtjen që duke ndjekur rrugën e integritit të mos ndihmojmë aemilimin e bashkësisë shqiptare dhe të përfshihet klasa punëtore. Përrshëndeti Kuvendin dhe tregoi gatishmëri që të bashkëpunon në mbarëvajtjen e punës së Shoqatës.

3. Ndarja e mirënjohjeve

Në këtë pikë të rendit të ditës, kryetari, dr. Sc. Ahmet Xhigoli bëri shpalljen e tre anëtarëve të nderit të Shoqatës dhe i dekoroi ata me mirënjohje përkatëse kandidatëve:

1. Artiste e popullit zonja Tinka Kurti, nga Shqipëria
2. Profesor Astrit Leka, nga Gjeneva
3. Drejtori i Universitetit Popullor Shqiptarë Ueli Leuenberger, nga Gjeneva.

Për secilin kandida, kryetari z. Xhigoli para të pranishmëve e ka bërë leximin e përmbajtjes së mirënjohjes.

Me këtë rast, z. Jetullah Haliti-Eti, mysafirëve që mundësuan organizimin e Ditëve të Filmit Shqiptarë në Zvicër, Artistës së Popullit Tinka Kurti dhe Drejtoreshës së Arkivit Qendror të Filmit Shqiptarë të Republikës së Shqipërisë Natasha Lako u dhuroi nga një reproduksion të Pikturës “Anatomiae veze” si shenjë mirënjohje e respektit në emërtë Kryesisë së BISHZ-së.

3. Të ndryshme

- **Referati “Dita e Pavarësisë:** Z. Gj. Iseini paratiti dhe lexoi një referat lidhur me Ditën e Pavarësisë” (më tepër shih sghtëjcën).
- **Promovimi i librit “SIDA Veprimet – Shpresa”:** Në këtë nënpikë u bë promovimii librit me titull “SIDA Veprimet – Shpresa” i përpiluar nën drejtimin e Prof. Luc Montagnier, përmbledhje e re e Institutit Paster, i përkthyer dhe përshtatur nga prim. Dr. Stom. Enver Pula.

Me këtë rast, z. N. Jakurti paratiti dhe lexoi disa fjalë rreth përkthimit dhe përshatjes së broshurës së përmendur (më tepër shih sghtëjcën).

Pas përfundimit të kësaj nënpike nën pikën e rendit të ditës “të ndryshme“ nuk pati ndonjë nënpikë tjetër konkrete. Pastaj, kryetari dr. sc. Ahmet Xhigoli e mbylli këtë Kuvend duke i ftuar të pranishmit në një koktej të cilin e organizoi kryesia e BISHZ-së.

Mbledhja e Kuvendit përfundoi në ora 17:00.

Udhëhqësi i protokolit: fil. i dipl. Giuliano Iseini

Bernë 08 dhjetor 1998